



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatori ekonomik “PE – VLA - KU” shpk

Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, Hyrja 1, Kati 7

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, “Rikualifikimi urban i zonës “Kodra e Diellit”-Faza I”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-58077-02-06-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikualifikimi urban i zonës “Kodra e Diellit”-Faza I”.

Fondi limit: 264,189,003.3 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë tre pikë tre) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr. 14 datë 13.02.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ELDA-VL” shpk

NUIS K67106202W

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i operatoreve ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk (EURO-ALB)
& “LLAZO” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk**

NUIS K66613407H & NUIS K24218401K & NUIS K47103804L

Vlera e ofertës: **167,963,236** (njëqind e gjashtëdhjet e shtatë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e e tre mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomik “INA” shpk & “ZEQILLARI” shpk & “2 N” shpk

NUIS J61814009W & NUIS L61912024O & NUIS L31615017L

Vlera e ofertës: **213,786,449.80** (dyqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatoreve ekonomik “NDERTIMI” shpk & “NDREGJONI” shpk

NUIS K01731001M & NUIS K31329048I

Vlera e ofertës: **224,680,365** (dyqind e njëzet e katër milion e gjatëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i operatoreve ekonomik “ALB SHPRESA” shpk & “Furst Koloss” shpk

NUIS J72110003F & NUIS J63229454K

Vlera e ofertës: **262,637,388.19** (dyqind e gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatoreve ekonomik “DESARET COMPANY” shpk & “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk

NUIS K01816001J & NUIS L04803001U

Vlera e ofertës = **197,743,549.09** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e dyzet e nëntë pikë zero nëntë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “AGI KONS” shpk

NUIS K21622001M

Vlera e ofertës = **264,046,557.16** (dyqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi i operatoreve ekonomik “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk

NUIS K02727229P & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës: **206,477,947** (dyqind e gjashtë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “PE – VLA - KU” shpk

NUIS K61716013M

Vlera e ofertës: **222,307,312** (dyqind e njëzet e dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik “LIQENI VII” sha

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës: **202,638,618** (dyqind e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

11. Operatori ekonomik “ALKO-IMPEX General Construcion” shpk

NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = **227,811,241.03** (dyqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një pikë zero tre) lekë pa TVSH.

12. Operatori ekonomik “CURRI” shpk

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = **205,750,017.88** (dyqind e pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “ELDA – VL” shpk

Operatori Ekonomik “**ELDA – VL**” shpk, nuk ka plotësuar asnjë nga kërkesat e percaktuara ne Dokumentat Standart te Tenderit.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk (EURO-ALB) & “LLAZO” shpk & “VIANTE Konstruksion” shpk

Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt”.....* Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se Operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk ka paraqitur deklaratën per Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt me inicialet B.M me profesion **Inxhinier Gjeodet**, cka bie ne kundërshtim me Udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: *“Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”*.

Operatori ekonomik “Llazo” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt”.....* Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se Operatori ekonomik “Llazo” shpk ka paraqitur deklaratën per Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt me inicialet A.LL por nga verifikimi i licensës së zbatimit të punimeve rezulton vetëm si drejtues ligjor dhe jo drejtues teknik.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomik “DESARET COMPANY” shpk & “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk

Bashkimi i operatoreve ekonomik “DESARET COMPANY & RSM&Hidro Company” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar....”* pasi stafi inxhinierk dhe teknik rezulton i

angazhuar ne kontratën me objekt “Rikonstruksioni rruges At Staf Melani” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “DESARET COMPANY & RSM&Hidro Company” shpk nuk potëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.....”* pasi mjetet rezultojne te angazhuara ne kontratën me objekt “Rikonstruksioni rruges At Staf Melani” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare, çka bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gjermës “g”, *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane”*.

4. Operatori ekonomik “CURRI” shpk

Operatori ekonomik Curri shpk, nuk ploteson piken 8/8.2, te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet se: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatësë, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument”*, pasi nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaraur per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatësë, si dhe institucionin qe ka leshuar kete document.

Operatori ekonomik Curri shpk, nuk ploteson piken 8/8.4, te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet se: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale”*, pasi nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaraur per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e deshmise së aftësisë profesionale.

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk se ka deklaruar 3 (tre Eskavator me goma, por vetem 2 (dy) plotesojne DST, pasi per 1 (nje) Eskavator me goma nuk ka deklaruar Targat, Numerin e Lejes se Qarkullimit, cka bie ne kundërshtim me kerkesat per plotesimin dhe deklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk se ka deklaruar 3 (tre) Fadrome me goma, por vetem 2 (dy) plotesojne DST, pasi per 1 (nje) Fadrome me goma, nuk ka deklaruar Targat, Numerin e Lejes se Qarkullimit, cka bie ne kundërshtim me kerkesat per plotesimin dhe deklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit, ku percaktohet se: *“Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8”*. Nga verifikimi i formularit permbledhes te vetedeklarimit, i paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk nuk ka paraqitur formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimeve ne Dokumentet Standarte te Tenderit per kete procedure prokurimi.

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit, ku percaktohet se: *“Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8”*. Nga verifikimi i formularit permbledhes te vetedeklarimit, i paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “Curri” Shpk, ne Deklaraten B, pika 7 eshte plotesuar gabim.

5. Bashkimi i operatoreve ekonomik “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk

Bashkimi i operatoreve ekonomik “ERGI & BE-IS” shpk nuk potëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar....”* pasi stafi inxhinierk dhe teknik rezulton i angazhuar ne kontratën me objekt “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rrugët 3 Dëshmorët - Rexhep Shala - Joaklin Persi” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “ERGI & BE-IS” shpk nuk potëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.....”* pasi mjetet rezultojne te angazhuara ne kontratën me objekt “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rrugët 3 Dëshmorët - Rexhep Shala - Joaklin Persi” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare, çka bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gërmës “g” , *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaronte se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane”*.

6. Bashkimi i operatoreve ekonomik “INA” shpk & “ZEQILLARI” shpk & “2 N” shpk

Operatori ekonomik 2N shpk, nuk ploteson pikën 2, të kapacitetit ekonomik e financiare të Dokumenteve Standarte të Tenderit”, “Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës.....”, pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur në sistemin e koktronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik 2N shpk, nuk ka paraqitur në SPE, vertetimin mbi xhiron vjetore.

Operatori ekonomik “Zeqillari” shpk nuk plotëson pikën 7, gërma “a” të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”)” pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit rezultoi se operatori ekonomik Zeqillari shpk, nuk ka deklaruar 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave .

Operatori ekonomik “INA” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar....” pasi stafi inxhinierik dhe teknik rezultoi i angazhuar në kontratën me objekt “Ndertim kopeshti dhe cerdhe e integruar Nr.50” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

Operatori ekonomik “INA” shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.....” pasi mjetet rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt “Ndertim kopeshti dhe cerdhe e integruar Nr.50” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare, çka bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gërmës “g” , “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaroi se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane”.

7. Operatori ekonomik “LIQENI VII” sha

Operatori ekonomik “LIQENI VII” sha nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, ku përcaktohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ftoi operatorin ekonomik “LIQENI VII” sha, që të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike brenda orës 15.00 të datës 19.04.2023. Operatori ekonomik nuk është pajtuar me kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pasi brenda orës 15.00 të datës 19.04.2023, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për

Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vendosi të s’kualifikojë ofertën e operatorit ekonomik “LIQENI VII” sha.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatori ekonomik “PE – VLA - KU” shpk**, me adresë: *Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, Hyrja 1, Kati 7*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **222,307,312** (dyqind e njëzet e dy milion e treqind e shtatë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **224,680,365** (dyqind e njëzet e katër milion e gjatëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO